

Agron (Bajram) Beriša

(16.06.1982, rom nga Dollci/Dolac, komuna e Klinës/Klina, punëtor)

Në datën **19.05.1998**, rreth orës 9:30, Burimi u nis në fshatin fqinj të **Grabanicës/Grabanica** për të bluar grurin. Kishte drojë që të shkonte vetëm dhe i ftoi miqtë nga fshati, Ivanin dhe Agronin, që të shkonin me të. U nisën me qerren me kuajt samari, e cila ishte pronë e babait të Burimit. Meqë nuk u kthyen deri në pasdite, dy të afërm të tyre u nisën për në Grabanicë/Grabanica për të parë çfarë kishte ndodhur me tre djelmoha. Në Grabanicë/Grabanica u ndalën nga tre apo katër shqiptarë të armatosur, të cilët u kërkuan dokumente identifikimi dhe, më pas, i regjistruan emrat e tyre. Pastaj, u thanë se kurrë nuk i kishin parë djelmohat e zhdukur. Një ditë më vonë, familjarët e të zhdukurve sërish shkuan në Grabanicë/Grabanica, në një përpjekje të re për të zbardhur fatin e tre të afërme të vet. U takuan me disa shqiptarë në uniforma, të cilët u kërcënuan me armë. Thanë se Ivani, Burimi dhe Agroni as që kishin ardhur në Grabanicë/Grabanica dhe u urdhëruan familjarëve që të braktisnin fshatin. Tri apo katër ditë më vonë, tre djem shqiptar nga Përlina/Prlina e sollën qerren e babait të Burimit në stacionin policor në Klinë/Klina. E kishin gjetur pranë shtëpisë së vet. Fati i Ivanit, Burimit dhe Agronit nuk është zbardhur as sot e kësaj dite. Në regjistrin e të zhdukurve që e administron KNKK-ja, rasti i Ivanit është evidentuar me numrin rendor YUK-050078-01, ai i Burimit me BLG-802896-01, ndërsa i Agronit YUK-050056-01.

Burimet: deklarata M.B, FDH-18654; deklarata M.Š, FDH-13463; deklarata R.B, FDH-16724; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 960, 972; deklarata S.M, FDH-15315; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\).](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-).)

Ukë (Sadik) Rexhepi

(30.09.1953, rom nga Dollova/Dolovo, komuna e Klinës/Klina, vullkanizor, nëntë fëmijë)

Nasret (Haki) Alijaj

(15.04.1975, rom nga Dollova/Dolovo, komuna e Klinës/Klina, dy fëmijë)

Në mëngjesin e datës **20.05.1998**, Nasreti, Uka dhe nipi i Ukës u nisën me biçikleta në treg në Klinë/Klina. Në kthim nga Klina, në mes të fshatrave **Grabanicë/Grabanica** dhe Dollovë/Dolovo, ata u ndalën nga dy shqiptarë në uniforma maskuese dhe armë automatike. Duke i kërcënuar se do t'i vrisnin, ata i kontrolluan Nasretin dhe Ukën dhe ua morën biçikletat dhe gjësendet nga xhepat. Më pas, me sytë të mbyllur me lecka dhe duart të lidhura prapa shpinës me gjalmë, i futën në makinë. Rrugës e liruan nipin e Ukës nga makina. Nga ajo ditë, për Nusretin dhe Ukën nuk ekziston asnjë gjurmë. Në regjistrin e të zhdukurve të përpiluar nga KNKK-ja, rasti i Nasretit është sistemuar në lëndën me numër YUK-050068-01, ndërkaq ai i Ukës më YUK-050071-01.

Burimet: deklarata F.A, FDH-18356; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008,

Isuf (Rexhë) Morina

(3.07.1950, shqiptar nga Grabanica/Grabanica, komuna e Klinës/Klina, punëtor, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Isufi ka qenë në përbërje të njësitit të UÇK-së *Shpati*, i cili vepronte në fshatin e tij të lindjes **Grabanicë/Grabanica**. Kur, më **20.05.1998**, rreth orës 18:00, forcat serbe e filluan bombardimin e fshatit Grabanicë/Grabanica, Isufi me një grup bashkëluftëtarësh gjendej në shtëpinë e Muzli Sahitajt. Një predhë eksplodoi në oborrin e shtëpisë dhe e vrau Isufin në vend, ndërkaq vetëm i plagosi disa të tjerë. Isufin e kanë varrosur në varrezat e Bokshiqit/Bokšić më 24. 05.1998. Pas përfundimit të luftës, më 2.10.1999, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica.

Burimet: deklarata H.M, FDH-33455;